REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES

Nr._____prot. Tiranë, më___.___.2026

V E N D I M

Nr.27, datë 06.11.2026

PËR
MIRATIMIN E UDHËZIMIT "RRJETE ME KAPACITET SHUMË TË LARTË"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	**Gentian Sala**	**Kryetar**
Znj.	**Edlira Dvorani**	**Anëtar**
Z.	**Armer Juka**	**Anëtar**
Z.	**Bleron Dokle**	**Anëtar**
Znj.	**Diana Dervishi**	**Anëtar**

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 06 nëntor 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" dhe Rregullores së Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)" miratuar me vendimin nr. 11, datë 31.03.2026, të Këshillit Drejtues të AKEP, me propozim të Drejtorisë së Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Miratimin e Udhëzimit "Rrjete me kapacitet shumë të lartë",

BAZA LIGJORE:

Nenet 108 dhe 191 i ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Udhëzimi “Rrjete me kapacitet shumë të lartë”;
2. Qëndrimi i AKEP, për komentet e palëve të interesuara pas këshillimin publik;
3. Projektvendimi i arsyetuar;
4. Relacioni shoqërues i Projektvendimit,

si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

VËREN:

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me vendimin nr. 17, datë 08.06.2026, ka miratuar për këshillim publik projektudhëzimin “Rrjete me kapacitet shumë të lartë ”.
2. Procesi i këshillimit publik për projektudhëzimin “Rrjete me kapacitet shumë të lartë (VHCN)” u zhvillua në faqen zyrtare të internetit të AKEP, për një periudhë 30-ditore, nga data 09.06.2026 - 09.07.2026.
3. Projektudhëzimi është hartuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 dhe mbështetet në Udhëzimin e BEREC BoR (25) 182 (Guidelines on Very High Capacity Networks), duke synuar harmonizimin e kuadrit rregullator shqiptar me praktikat më të mira evropiane në fushën e komunikimeve elektronike.
4. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, në rrugë elektronikë, në datën 09.07.2026 pranë AKEP, janë depozituar komente nga sipërmarrësit “Vodafone Albania” sh.a. dhe “One Albania” sh.a.
5. Projektudhëzimi ka pësuar disa përmirësime dhe qartësime në raport me dokumentin e miratuar për këshillim publik, të cilat janë reflektuar në dispozitat e tij, si dhe në Aneksin 1 që i bashkëlidhet udhëzimit.
6. Ndryshimet e reflektuara lidhen kryesisht me specifikimin e teknologjisë G.fast 212 MHz dhe referenca më të qarta ndaj teknologjive alternative të aksesit. Këto përditësime pasqyrojnë zhvillimet teknologjike që merren në konsideratë për vlerësimin e performancës së rrjeteve fikse. Nga vlerësimi i kryer, këto ndryshime nuk cenojnë parimet, strukturën dhe metodologjinë e ndjekur në udhëzimin e hartuar nga AKEP. Megjithatë, për të garantuar përputhshmërinë me versionin më të fundit të udhëzimeve të BEREC, janë kryer përshtatjet përkatëse në terminologjinë teknike dhe në referencat ndaj teknologjive të aksesit.
7. Në përfundim të procesit të këshillimit publik dhe analizimit të komenteve të paraqitura është hartuar:
    - Udhëzimi “Rrjete me kapacitet shumë të lartë (VHCN)”, që përbën dokumentin përfundimtar për miratim dhe
    - Dokumenti “Qëndrimi i AKEP mbi komentet e palëve të interesuara”, në të cilin paraqitet vlerësimi i AKEP për komentet dhe propozimet e ardhura.
8. Nga pikëpamja e ligjshmërisë, Udhëzimi është në përputhje me përcaktimet e nenit 108 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 1 të nenit 14, dhe pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzimin "Rrjete me kapacitet shumë të lartë", si dhe Qëndrimin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Ky Vendim dhe dokumentat e miratuara në pikën 1 të tij, publikohen në faqen zyrtare të internetit www.akep.al.
3. Ngarkohet administrata e AKEP, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	**Edlira Dvorani**	**Armer Juka**	**Bleron Dokle**	**Diana Dervishi**